



Republika e Kosovës
Komuna e Malishevës



Drejtoria për Administratë dhe Përsone

Zyra e Prokurimit

Nr 03/ 44

Datë 11/08 2021.

KONTRATË PROKURIMI Nr 24

Komuna e Malishevës (në vazhdim " Autoriteti Kontraktues "), në njëren anë; dhe " **TONI INGJINJERING " SH.P.K** me seli në **GLLOGOC** me **Nr.biznesi 810199861** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

**FURNIZIM ME GOMË PËR VENDOSJEN NË BARIN SINTETIK TË FUSHËS SË FUTBOLLIT TË
MADHË " LIMAN GEGAJ " NË MALISHEVË**

me numër identifikues : **62500.21.4721.136/62500.21.094.136**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **FURNIZIM ME GOMË PËR VENDOSJEN NË BARIN SINTETIK TË FUSHËS SË FUTBOLLIT TË MADHË " LIMAN GEGAJ " NË MALISHEVË.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me rastin e nënshkrimit dhe përfundon me kryerjen e furnizimit me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushës së futbollit të madhë " Liman Gegaj " në Malishevë.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i furnizimit dhe vendosjes së gomës do të jetë në stadiumin " Liman Gegaj " në Malishevë.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP⁴ (Detyra e Dërguar e Pagua).

⁴ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 **Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 **ÇMIMI**

3.1 **Çmimi total i kontratës është: 4,800.00€ (me shkronja) (katërmijëetëqindëeuro).**

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës.

Neni 3.3 **Menaxhimi i Kontratës**

Menaxhimin e Kontratës furnizim me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushës së futbollit të madhë “Liman Gegaj” në Malishevë do ta bëjë zyrtari i drejtoris së DKRS-së **z.Albert Morina** caktuar nga ZKA-ja e AK-së.

Neni 3.4. **Obligimet e OE**

OE është i obliguar që furnizimin me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushës së futbollit të madhë “Liman Gegaj” në Malishevë ta kryej në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertës. Furnizim me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushës së futbollit të madhë Liman Gegaj në Malishevë duhet të jetë në cilësi dhe sasin e kërkuar nga AK. Nëse furnizimi me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushës së futbollit të madhë Liman Gegaj në Malishevë nuk është në cilësin dhe sasin e kërkuar nga AK dhe në përputhëshmëri me specifikacionin e ofertës do të i kthehet operatorit ekonomik dhe shpenzimet e bëra biejnë në llogari të operatorit ekonomik. Kontraktuesi i parë (AK) e ruan të drejtën që t’a ndërprej kontratën me kontraktuesin e dytë për mos realizimin e kontratës në cilësi dhe afatë .

Neni 3.5 Afati i furnizimit

Furnizimi me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushes së futbollit të madhë Liman Gegaj në Malishevë duhet të jetë në cilësi dhe sasin e kërkuar nga AK mund të fillojë që nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe do të përfundojë brenda 5 ditëve.

Neni 4 PAGESA

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Obligohet kontraktuesi i parë (AK) që pasi t'a pranon raportin e pranimi të furnizimit me gomë për vendosjen në barin sintetik të fushes së futbollit të madhë Liman Gegaj në Malishevë nga zyrtari përkatës dhe faturën ta paguaj shumën sipas nen. 3 dhe 3.1 të kësaj kontrate (pagesa kontraktuesit të dytë do të i bëhet në bazë të raportit të zyrtarit të DKRS-së **z.Albert Morina**).

Ndërsa pagesa finale do të bahët pas pranimi teknik të komisioni i caktuar nga ZKA-ja e AK-së.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për **12 muaj**, pas pranimi të furnizimit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]** [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda

limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizim.

Neni 11 Ndërrprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.




Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Operatorin Ekonomik.

Për Autoritetin Kontraktues

Për Operatorin Ekonomik

Emri:	Nuhi Shalaj	Emri:	Malush Krasniqi
Pozita:	Menagjer i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	11.08.2021	Data:	11.08.2021
Vula:		Vula:	

Mirëmbajtja e barit sintetik në stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë

<i>Specifikacion</i>					
Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	çmimi	Shuma
1	Furnizimi dhe vendosja e SBR-GRANULATIT mbi barin sintetik në stadiumin “Liman Gegaj” në Malishevë.	ton	8	600.00	4800.00
Totali					4800.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	‘TONI INGJINJERING’SH.P.K
ADRESA E PLOTE	NEGROFC - GLLOGOC
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	MALUSH KRASNIQI
POZITA	PRONAR